



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . 2023

**VENDIM**

**Nr. 211, datë 26.04.2023**

**PËR**

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE  
TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU  
USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

- I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatën në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC**

1. Gjyqtarët i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Seladin Pysqyli dhe Eglantina Mikani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: Bexhet Hoxhallari; Akuza: “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë – nenet 76 e 22 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gentiana Shukullari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I Pandehur: Meard Berberi, etj; Akuza: “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” në bashkëpunim e mbetur në tentativë- nenet 79/ë, 25 dhe 22 të Kodit Penal , etj.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Luljeta Kole, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me të Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Pogradec; I Pandehur: Gaqo Mile; Objekti: Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq; Akuza: “Kallëzim i rremë” - neni 305 i Kodit Penal.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Eglantina Mikani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: Fatjon Papajanis, Arbri Hoxha; Akuza: “Trafikim i narkotikëve” në bashkëpunim – neni 283/a paragrafi 2 dhe “Kalim i paligjshëm i kufirit” – neni 297 i Kodit Penal Objekti: Kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Thomaidha Roça, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: Spartak Çela; Akuza: Nenet 76, 22 e 278/1 të Kodit Penal.

6. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gentiana Shukullari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Viktimë akuzuese: Elis Cake; I akuzuar: Marjus Galla; Palë e interesuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; Akuza: “Dëmtime të tjera me dashje”- neni 90/2 i Kodit Penal.

7. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Thomaidha Roça, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Paditës: Nexhmi Hoxha; I paditur: Urim Zade; Objekti: Shpërblim dëmi – nenet 31, 32/a, 154 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 608 e vijues të Kodit Civil.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**